



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

RREGULLORE

**“PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË”**

Tiranë, 2020

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i rregullores

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara, si dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe rregullat që zbatohen nga subjektet pjesëmarrëse në procesin për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe organeve përgjegjëse për promovimin e personelit akademik, si dhe raportet me organet dhe autoritetet përgjegjëse për promovimin e personelit akademik.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bazohet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor””, i ndryshuar, aktet e tjera nënligjore në fuqi, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si dhe akte të tjera nënligjore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 3

Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT

Organi kolegjal përgjegjës për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, është Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik (KPPPA).

Neni 4

Kriteret e përgjithshme për fitimin e titujve akademikë në UMT

1. Për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar” mund të aplikojë personeli akademik i kategorisë “Lektor”, i cili ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” të paktën 5 (pesë) vjet para datës së aplikimit për fitimin e titullit të mësipërm.

2. Për fitimin e titullit akademik “Profesor” mund të aplikojë personeli akademik i cili ka titullin akademik “Profesor i asociuar”. Personeli akademik, i cili mban titullin akademik “Profesor i asociuar” aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor” të paktën 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”.
3. Konsiderohet datë e mbrojtjes së gradës shkencore/titullit akademik, data e vendimit final të organit përgjegjës për dhënien e gradës/titullit, bazuar në legjislacionin në fuqi në kohën kur kjo gradë/titull është dhënë.
4. Kanë të drejtë të kërkojnë promovim për tituj akademikë:
 - a) anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b) anëtarët e personelit akademik të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në rastet kur këto Institucione të Arsimit të Lartë nuk përmbushin kriteret për promovim akademik;
 - c) personat që nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet dhe kriteret për fitimin e titujve akademikë.

Neni 5

Kritere vlerësuese akademiko-didaktike për fitimin e titujve akademikë në UMT

1. Personeli akademik, që aplikon për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, përveç përmbushjes së detyrueshme të kriterëve të përgjithshme dhe standarteve shtetërore, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në këtë rregullore do të vlerësohet edhe për kriteret e mëposhtme:
 - a) kontributi institucional ku përfshihen veprimtaritë akademike dhe administrative në mbështetje të njësive bazë, njësive kryesore, institucionit dhe administratës publike.
 - b) pjesëmarrja në borde revistash shkencore apo serial botimesh shkencore (joperiodike) apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit.
 - c) hartim projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - c) aftësi drejtuese akademike dhe kryerja e detyrave menaxheriale brenda universitetit dhe jashtë tij.
 - d) çmime kombëtare dhe ndërkombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës.

KREU II

STANDEDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK “PROFESOR I ASOCIUAR”

Neni 6

Përvoja akademike për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”

1. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin “Profesor i asociuar”, duhet:
 - a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;

- b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5-vjeçare (pesëvjeçare), me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
- c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle dhe në gjuhën shqipe para jurisë (ose të mbrojtë veprimtarinë kërkimore botues përpara Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në një nga gjuhët e mësipërme (sipas VKM 112 Kreu II pika 4, gërma c)) në përputhje me Statutin e UMT-së, në këtë rregullore si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 7

Botimet e realizuara nga kandidati për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”

1. Personeli akademik, që aplikon për titullin “Profesor i asociuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:
 - a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Journal Citation Reports **dhe/ose Scopus**¹. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
 - b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 8

Monografia shkencore për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”

1. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1 të nenit 6, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e originalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor

¹ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së nr. 102, datë 20.10.2020 “Për disa ndryshime ...”

nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës si dhe konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është e aprovuar nga Këshilli i Botimeve në UMT².

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

- i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

- i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

Neni 9

Promovimi akademik në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari të tjera akademike për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”

1. Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, në:
 - a) komitete shkencore apo redaktuese;
 - b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
 - d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - e) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - g) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Neni 10

Ekuivalentimi në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari të tjera për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”

1. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në së paku 4 (katër) veprimtari të përcaktuara në nenin 8, mund të ekuivalentohet me:
 - a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;
 - b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

² Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së nr. 75, datë 30.09.2022 “Për një ndryshim ...”

2. Pavarësisht numrit të lartë të angazhimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit në veprimtari shkencore, nuk mund të bëhet më shumë se 1 (një) ekuivalentim sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1/a/b të këtij neni.
3. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 9, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.

Neni 11

Realizimi i studimit postdoktoratë në një nga vendet anëtare të BE-së

1. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me:
1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 12

Vlefshmëria e botimeve shkencore për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar"

1. Për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "Doktor", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor i asociuar".
2. Konsiderohen revista shkencore brenda vendit ato të miratuara nga Senati Akademik i UMT-së si dhe ato të renditura në listën e plotë të revistave shkencore të botuara brenda vendit, të publikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

KREU III

STANDARTET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK "PROFESOR"

Neni 13

Përvoja akademike për fitimin e titullit akademik "Profesor"

1. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:
 - a) të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
 - b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë si lektor për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, pas fitimit të gradës shkencore "doktor", ose me

kohë të pjesshme, si lektor, për një periudhë 12-vjeçare (dymbëdhjetëvjeçare) akademike pas fitimit të gradës shkencore “doktor”;

- c) të ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduara;
- ç) të jetë i aftë të mbajë ligjërata në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle dhe në gjuhën shqipe para jurisë (ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botues përpara Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në një nga gjuhët e mësipërme (sipas VKM 112 Kreu II pika 4, gjëra c)) në përputhje me Statutin e UMT-së, në këtë rregullore si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 14

Botimet e realizuara nga personeli akademik nga kandidati për fitimin e titullit “Profesor”

1. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - a) Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Journal Citation Reports dhe /ose Scopus³. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
 - b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 15

Monografia shkencore për fitimin e titullit “Profesor”

1. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 14, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Profesor i asociuar” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është

³ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së nr. 102, datë 20.10.2020 “Për disa ndryshime ...”

e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës si dhe konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është e aprovuar nga Këshilli i Botimeve në UMT⁴.

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

- i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

- i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

Neni 16

Promovimi akademik në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari akademike për fitimin e titullit “Profesor”

1. Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”, në:
 - a) komitete shkencore apo redaktuese;
 - b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
 - d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - e) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - g) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Neni 17

Ekuivalentimi në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari akademike për fitimin e titullit “Profesor”

1. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në 1 (një) ose më shumë veprimtari të përcaktuara në nenin 15, mund të ekuivalentohet me:
 - a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;
 - b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, dhe 2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga

⁴ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së nr. 75, datë 30.09.2022 “Për një ndryshim ...”

vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

2. Pavarësisht numrit të lartë të angazhimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit në veprimtari shkencore, nuk mund të bëhet më shumë se 1 (një) ekuivalentim sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1/a/b të këtij neni.
3. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 16, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.

Neni 18

Vlefshmëria e botimeve shkencore për fitimin e titullit akademik “Profesor”

1. Për fitimin e titullit akademik “Profesor”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik “Profesor i asociuar” deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor”.
2. Konsiderohen revista shkencore brenda vendit ato të miratuara nga Senati Akademik i UMT si dhe ato të renditura në listën e plotë të revistave shkencore të botuara brenda vendit, të publikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

KREU IV

PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 19

Paraqitja e kërkesës dhe dosjes për aplikim

1. Kandidati paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë brenda 20 (njëzet) ditëve.
2. Kandidatët e kategorive të pikave b dhe c, të pikës 4, neni 4; paraqesin kërkesën dhe dosjen pranë KPPPA-së. Ky komision vendos se cila është njësia kryesore më e përshtatshme për promovimin e kandidatit dhe ia përcjell dosjen kësaj të fundit për fillim të procedurës. Njësia kryesore bën gjithashtu vlerësimin e njësisë bazë më të përshtatshme për vlerësimin e kandidatit dhe ia përcjell dosjen kësaj njësie bazë për vlerësim sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Pas vlerësimit nga njësia bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, dosja e kandidatit përmes drejtuesit të njësisë kryesore përkatëse i përcillet Senatit Akademik, i cili përmes kryetarit të tij, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e dosjes, ia përcjell Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.
4. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ, dosja i kthehet drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse.
5. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sërish, brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh.
6. Vendimi i njësisë bazë merret nga shumica e anëtarëve të saj.

Neni 20

Ngritja e jurisë për vlerësimin e dosjes

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Senati Akademik i UMT-së, Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati përmban ose jo dokumentacionin përkatës, duke caktuar për këtë qëllim 2 (dy) relatorë nga KPPPA-ja, të cilët, kur është e mundur, janë anëtarë të njësisë kryesore ku ka dorëzuar dosjen kandidati që kërkon të fitojë titullin akademik.
2. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT vijon menjëherë, në të njëjtën mbledhje, me ngritjen e jurisë për vlerësimin e dosjes.
3. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, atij i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.
4. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me titullin akademik “Profesor” të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, të paktën, 2 (dy) duhet të jenë të ftuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja ose personalitete të spikatur të fushës.
5. Anëtarët e jurisë propozohen në Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik të UMT-së nga drejtuesi i njësisë kryesore sipas propozimit të njësisë bazë, me miratimin e rektorit, brenda 10 (dhjetë) ditëve, së bashku me dosjen e kandidatit të miratuar në njësinë bazë.
6. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë), nga të cilët 5 të jenë të brendshëm dhe 3 të jashtëm.

Neni 21

Procedura e vlerësimit

1. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së jurisë.
2. Kandidati në kërkim të fitimit të titullit akademik mban 2 (dy) leksione në praninë e jurisë së ngritur. Kryetari i jurisë njofton Kryetarin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT për datat, orën dhe vendin e zhvillimit të leksioneve. KPPPA ka të drejtë të marrë pjesë në secilin prej këtyre leksioneve. Një nga këto leksione duhet mbajtur në njërën nga gjuhët e huaja të përcaktuara në nenin 6, pika 1, shkronja c.
3. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, juria përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko-didaktike e shkencore të kandidatit, në përfundim të të cilit jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit i përcillet Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.
4. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marrjes së raportit të vlerësimit nga juria.

Neni 22

Përsëritja e kërkesës për fitimin e titujve akademikë

Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën, pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme, pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 23

Regjistrimi i titullit akademik

1. Titulli akademik regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin / strukturave të autorizuara sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi dhe në regjistrin e gradave shkencore dhe titujve akademikë të Universitetit të Mjekësië, Tiranë.
2. Titulli akademik lëshohet nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë dhe nënshkruhet nga rektori, si rregull brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dhënies së vendimit përfundimtar nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.

Neni 24

Revokimi i titujve akademikë

Rektori merr vendimin për revokimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, në rastet kur vërtetohet plagjiatura ose manipulimi i të dhënave në punimet e kandidatit, pas marrjes së mendimit nga njësia bazë përkatëse dhe miratimit me shumicë të cilësuar (nga 11 anëtarë) nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.

KREU V

TITUJ PËR KONTRIBUT TË VEÇANTË

Neni 25

Titulli “*Doctor Honoris Causa*”

1. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë mund të akordojë titullin “*Doctor Honoris Causa*” për figura të shquara të shkencës e shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit e të shkencës, si dhe në zhvillimin e vendit tonë në tërësi.
2. Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik të UMT-së, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Numri i titujve “*Doctor Honoris Causa*” nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit.

Neni 26

Kriteret për fitimin e titullit “*Profesor emeritus*”

1. Personelit akademik që mban titullin “*Profesor*”, pas daljes në pension në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik të UMT-së i akordohet titulli “*Profesor emeritus*”, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
2. Titulli “*Profesor emeritus*” u jepet profesorëve në pension, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në drejtim të veprimtarisë akademike, duke përfshirë dhe arritjet e dedikuara në fushën përkatëse të kërkimit shkencor.
3. Titulli i nderit “*Profesor emeritus*” i jepet personelit akademik, që plotëson kriterin e përgjithshëm të mbajtjes së titullit “*Profesor*” të paktën 5 vjet.
4. Individit që mban titullin “*Profesori emeritus*” nuk mund të jenë punonjës efektiv i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Nëse individit që mban titullin “*Profesori emeritus*”, për arsye apo nevoja të ndryshme të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kthehet në punë, atëherë ai trajtohet financiarisht si personel akademik “*Profesor*”.

Neni 27

Procedura e aprovimit të titullit “*Profesor emeritus*”

1. Njësia bazë vendos të bëjë rekomandimin mbi dhënien e titullit akademik “*Profesor Emeritus*”, i cili do të bëhet me shkrim tek drejtuesi i njësisë kryesore, duke bashkëngjitur një kopje të *Curriculum vitae* si dhe veprimtari të tjera si më poshtë:
 - a) pëlqimin e profesorit në formë deklarate;
 - b) relacion mbi performancën e mësimdhënies dhe punën e tij krijuese nga njësia bazë, ku ai ka ushtruar veprimtarinë si personel akademik;
 - c) relacione mbi rezultatet e punës mësimore dhe kërkimore, dëshmi kualifikimesh, brenda dhe jashtë shtetit, bursa kualifikimesh e bashkëpunimesh me institucione të huaja, realizime projektesh të përbashkëta, certifikata referimesh dhe pjesëmarrje në konferenca dhe veprimtari të tjera;
 - d) rekomandime nga institucione homologe, dikastere, qendra studimore dhe eksperimentale, nga institucione të fushës së shëndetit, borde pedagogjike dhe studentore.
2. Dekanati i njësisë kryesore shqyrton rekomandimin e njësisë bazë, bashkë me dokumentat e lartpërmendur dhe e përcjell me shkresë tek Rektori i UMT-së, rekomandimin për dhënien e titullit “*Profesor Emeritus*” duke dhënë edhe opinionin e tij.
3. Rektori gjykon veprimtarinë e profesorit dhe përputhshmërinë ligjore të dosjes dhe përcjell rekomandimin për miratimin e titullit, Senatit Akademik.
4. Senati Akademik do të vendosë me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë, nëse do të miratojë rekomandimin dhe do të marrë vendimin për dhënien e titullit akademik “*Profesor emeritus*”.

5. Vendimi i Senatit Akademik firmoset nga Kryetari i Senatit dhe i përcillet strukturës përkatëse për regjistrim në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë si dhe në regjistrin e UMT-së.
6. Pas regjistrimit, Dega e Kërkimit Shkencor, përgatit kartonin, të cilin e firmos Kryetari i Senatit, dhe në një ceremoni, drejtuesi i njësisë kryesore dhe/ose Rektori i dorëzojnë Profesorit titullin “*Profesor emeritus*”.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 28

Përfundimi i procedurave të filluara për marrjen e titujve akademikë në UMT

1. Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” dhe kanë kaluar fazën e miratimit nga Këshilli i Profesorëve, e mbyllin procedurën për marrjen e titullit akademik sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi në momentin e dorëzimit të dosjes në Këshillin e Profesorëve. Këta kandidatë ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë rregullore për fazën përfundimtare në Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik të UMT-së.
2. Të gjithë kandidatët e tjerë që kanë aplikuar në njësitë bazë ose kryesore për titull akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” dhe që nuk kanë kaluar fazën e miratimit nga Këshilli i Profesorëve, aplikojnë për tituj akademikë konform kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore dhe/ose përditësojnë dosjet e depozituara duke shprehur vullnetin për të vijuar me procedurat e mëtejshme sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. Kandidatët për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” të cilët kanë të miratuar jurinë e vlerësimit nga Këshilli i Profesorëve konform ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i shfuqizuar; vazhdojnë procedurën si vijon: juritë hartojnë raportet e vlerësimit konform kriterëve të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i shfuqizuar, dhe ia përcjellin Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik të UMT-së. Ky komision e përfundon procedurën e vlerësimit konform pikës 4 të nenit 21 të kësaj rregulloreje (brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve).
4. Kandidatët për fitimin e titullit “Profesor”, të cilët kanë të miratuar jurinë e vlerësimit konform ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i shfuqizuar; vazhdojnë procedurën si vijon: juritë hartojnë raportet e vlerësimit konform kriterëve të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i shfuqizuar dhe ia përcjellin Senatit Akademik të UMT-së. Raportet vlerësohen nga Senati Akademik, i cili cakton 2 (dy) relatorë mes anëtarëve të tij për secilën dosje. Relatorët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e raporteve, dorëzojnë relacionet e tyre të vlerësimit

pranë Senatit Akademik. Senati Akademik në mbledhjen e parë pas këtij dorëzimi, shprehet pro ose kundër dhënies së titullit. Në vijim, praktika e plotë i përcillet Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik për hartimin e vendimit final për kandidatët, vendim i cili regjistrohet në regjistrin përkatës të UMT si dhe përcillet për regjistrim në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin / strukturave të autorizuar sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 29

Interpretimi i Rregullores

Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 30

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. ARBEN GJATA

